



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave  
Ministry of Local Government Administration

---

Departamenti për Integritet Evropian dhe  
Koordinim të Politikave

# Analizë

Profili dhe kriteret e madhësisë së administratës  
komunale në Republikën e Kosovës

## MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL - MAPL

### DEPERAMENTI PËR INTEGRIME EVROPIANE DHE KOORDINIM TË POLITIKAVE - DIEKP

Kjo analizë është produkt i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal – MAPL, e realizuar nga Departamenti për Integritime Evropiane dhe Koordinim të Politikave – DIEKP.

*Analiza është realizuar nën përkujdesjen:*

**Isuf ZENELI** – Udhëheqës i Divizionit për Koordinim të Politikave  
[Isuf.zeneli@rks-gov.net](mailto:Isuf.zeneli@rks-gov.net)

*Analiza është hartuar nga:*

**Ferdi KAMBERI** – Zyrtar për Koordinim të Politikave  
[Ferdi.kamberi@rks-gov.net](mailto:Ferdi.kamberi@rks-gov.net)

I ndihmuar nga:

**Shkelqim JAKUPI** – Zyrtar për Zhvillim të Dokumenteve Strategjike  
[Shkelqim.jakupi@rks-gov.net](mailto:Shkelqim.jakupi@rks-gov.net)

**Mimoza T. BAJRAKTARI** – Zyrtare për Zhvillim të Politikave  
[Mimoza.T.Bajraktari@rks-gov.net](mailto:Mimoza.T.Bajraktari@rks-gov.net)

## Përmbajtja

Shkurtesat.....	4
Hyrje .....	5
1. Kuptimi i administratës komunale.....	6
2. Kategoritë që përfshihen në administratën komunale .....	7
3. Gjendja aktuale e administratës komunale në Republikën e Kosovës .....	7
4. Kriteret aktuale të madhësisë së administratës në Republikën e Kosovës .....	10
5. Gjendja aktuale e të punësuarve në administratat e komunave të Republikës së Kosovës .....	13
6. Komunitet të cilat kanë tejkaluar numrin e punonjësve.....	14
7. Komunitet të cilat kanë mungesë të punonjësve .....	16
8. Përvojat e shteteve të rajonit dhe Evropës lidhur me Administratën komunale.....	17
9. Dallimet në mes të administratës komunale në Kosovë dhe shteteve tjera.....	19
10. Profili i administratës publike në Republikën e Kosovës.....	19
11. Përfundim .....	20
12. Rekomandimet .....	21
13. Burimet/literatura .....	23

**Shkurtesat**

<b>ASK</b>	Agjencioni i Statistikave të Kosovës
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>BNJ</b>	Burimet Njerëzore
<b>LKA</b>	Ligji për Kufijtë Administrativ
<b>LVL</b>	Ligji për Vetëqeverisje Lokale
<b>MAPL</b>	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
<b>MAP</b>	Ministria e Administratës Publike
<b>MASHT</b>	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
<b>PL</b>	Pushteti Lokal
<b>PQ</b>	Pushteti Qendror
<b>UA</b>	Udhëzim Administrativ

## Hyrje

Bazuar në planin e punës së Divizionit për Koordinim të Politikave në kuadër të Departamentit për Integritim Evropian dhe Koordinim të Politikave dhe nevojave të MAPL-së lidhur me punën e vazhdueshme dhe mbështetjen në raport me qeverisjen lokale, është parë e nevojshme hartimi i kësaj analize. Analiza në fjalë ka për qëllim që të analizon dhe të paraqes gjendjen aktuale të administratës komunale në Republikën e Kosovës, krahasimet me dokumentet ligjore të cilat caktojnë kriteret e madhësisë së administratës komunale, krahasimet me disa vende të rajonit dhe të BE-së, si dhe ndryshimet eventuale të administratës komunale me rastin e regjistrimit të popullsisë nga ASK-ja. Analiza është hartuar duke u bazuar nga të dhënat e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministrisë së Administratës Publike, Agjencionit të Statistikave të Kosovës, si dhe burimeve tjera parësore dhe dytësore.

Qeveria e Republikës së Kosovës, më datë 03.12.2008, ka nxjerrë Vendimin me Nr. 10/46 me të cilit caktohen kriteret e madhësisë së administratës komunale në Republikën e Kosovës. Megjithatë edhe pse janë evidentuar disa lëshime në këtë vendim lidhur me kriteret për ndarjen e komunave sipas numrit të banorëve dhe kriterëve për caktimin e numrit të punonjësve të administratës komunale, ky vendim jep sqarime të mjaftueshme të kriterëve për madhësinë e administratës komunale, duke u bazuar në aneksin B të këtij vendimi.

Vendimi i lartpërmendur cakton kriterin bazë të të punësuarve për të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, që është 55 (pesëdhjetë e pesë) punonjës, dhe kriterin suplementar që caktohen sipas numrit të popullsisë së komunave. Sipas këtij kriteri, përkatësisht aneksin B të Vendimit, së pari është bërë ndarja e komunave me mbi 100000 (njëqindmijë) banorë dhe komunave me më pak se 100000 (njëqindmijë) banorë. Duke u bazuar në këtë tabelë shohim se për komunat me mbi 100000 (njëqindmijë) banorë është caktuar kriteri suplementar që për çdo 750 banorë të ketë nga një punonjës administrativë. Ndërsa për komunat me më pak se 100000 (njëqindmijë) banorë është caktuar kriteri suplementar që për çdo 620 banorë të ketë nga një punonjës administrativë.

Aktualisht, administrata komunale në Republikën e Kosovës është e mbingarkuar, në vitin 2004 ka pasur 4826 punonjës, ndërsa në vitin 2013 ka rreth 6384 punonjës, gjë që i bie se dukshëm është rritur numri i punonjësve në administratën komunale, ku kjo mund të ndikojë në mbingarkimin e buxhetit, stabilitetin e administratës, profesionalizimin e shërbyesve civil dhe në shpërndarjen e drejt të shërbimeve për qytetarët.

Metodat që janë përdorur në këtë analizë janë: metoda e krahasimit, metoda statistikore, analiza e përmbajtjes dhe metoda e studimit të literaturës.

## 1. Kuptimi i administratës komunale

Në përgjithësi sot kur flitet për administratën publike si koncept, por edhe si art i qeverisjes lokale, ajo shihet si pjesë e administrimit publik. Andaj, administrata si koncept ka “dy domethënie themelore të fjalës „administratë”: administrata si përmbledhje e organizatave administrative dhe administrata si veprimtari e caktuar. Më së shpeshti përdoret koncepti i administratës si veprimtari e caktuar (veprimtaria funksionale ose objektive) dhe si organizatë (definicioni organizativ ose objektiv). Megjithatë, kjo ndarje nuk është precize. Definicionet më tutje mund të ndahen në përmbajtësore dhe materiale, pozitive dhe negative (p.sh. administrata është veprimtari shtetërore, e cila nuk është as ligjvënies as gjyqësi”<sup>1</sup>.

Nga kjo lë të kuptohet se pavarësisht faktit që ekzistojnë një sërë definicionesh mbi administratën, megjithatë ajo është e lidhur me zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, kulturor dhe shoqëror. Në këtë drejtim, administrata del si hallkë e shtetit e cila ka rol dhe rëndësi të madhe në zhvillimin e vet shtetit si mekanizëm shtetëror dhe si e tillë ajo është njëkohësisht edhe instrument dhe bartëse e punëve të dobishme të cilat kënaqin nevojat e qytetarëve.

Ndaj, në rrjedhën e karakteristikave dhe parimeve, administrata padyshim se lidhet me disa parime të cilat e bëjnë atë edhe më funksionale, si: parimin e efikasitetit, parimin e efektivitetit, si dhe parimin profesional. Të gjitha këto parime pasqyrojnë faktin se administrata në përgjithësi është dhe duhet të jetë në shërbim të qytetarëve. Së këndejmi, kur flitet për administratën publike përkatësisht për llojet e saj, aty bëjnë pjesë: administrata shtetërore, administrata komunale (lokale), disa bartës të autorizimeve publike, gjegjësisht agjencionet publike, entet publike të cilët kryesisht kryejnë punë administrative dhe fonde publike. Ndërsa, personat që kryejnë shërbimet në administratën publike zakonisht njihen si shërbyes civil.

Kështu që, nga ky elaborim që bëmë deri më tani mund të theksojmë se administrata komunale (lokale) është formë e rregullimit të pavarur dhe zgjidhje e nevojave jetësore të qytetarëve të atij territori administrativ - komunës, “sipas rregullës në suaza të ngushta vendore, të organizuar, por në mënyrë të paautorizuar. Për dallim nga administrata shtetërore, për të cilën është me rëndësi rregullimi i hierarkisë – të varësisë së organeve më të ulët, centralizimi, racionalizimi dhe efektshmëria për vetëadministrimin (lokal) janë të rëndësishme, autonomia dhe mëvetësia, decentralizimi dhe demokratizimi”<sup>2</sup>. Pra, me fjalë të tjera shihet se administrata komunale është organ i Kuvendit të Komunës dhe zbaton vendimet e kuvendit. Administrata Komunale është përgjegjëse për të zbatuar të gjitha detyrat ekzekutive që i janë përcaktuar me statut dhe akte tjera normative.

<sup>1</sup> Prof. dr. Gjermo, Zenaïd: “*Teoria e Administratës Publike*”, AAB, Prishtinë, 2008, fq. 3.

<sup>2</sup> Po aty, fq. 124.

## 2. Kategoritë që përfshihen në administratën komunale

Veprimtaria e administratës është e llojllojshme në raport me llojet e punëve dhe detyrave të cilat bëjnë pjesë në të, por kjo llojllojshmëri shprehet edhe në format metodologjike të natyrës së punës apo vetë stilit të përdorur në punë me qëllim që secila kategori që përfshihet në administratën komunale t'i ketë specifikat e saj. Ndarja e punës dhe kategoritë që përfshihen në administratën komunale ndikojnë dukshëm në specializimin e punës dhe rritjen e përgjegjësisë në raport me qytetarët. Sido që të jetë, kategoritë që përfshihen në administratën komunale të Republikës së Kosovës janë të specifikuara në kuadër të fushave dhe segmenteve brenda nivelit komunal. Megjithatë, administrata lokale sipas LVL-së organizohet në drejtorate, ku çdo drejtorat komunal menaxhohet nga drejtori, të cilin e emëron dhe e shkarkon kryetari i komunës. Po ashtu, administrata lokale ka edhe udhëheqësin e personelit i cili kryen detyrat konform përgjegjësive që ka. Pra, nga kjo del se kategoritë të cilat përfshihen në administratën komunale janë:

Nr.	Kategoritë
1.	Drejtorët
2.	Shërbyesit civil

**Tabela 1:** Pasqyrimi i kategorive që përfshihen në administratën komunale.

Sic mund të shihet nga tabela e mësipërme, kategoritë që përfshihen në administratën lokale janë: drejtorët dhe shërbyesit, të cilat më pastaj janë të specifikuara dhe të ndara nga komuna në komunë, sipas kriterëve të përcaktuara mbi madhësinë e administratës dhe fushave përkatëse të komunave.

## 3. Gjendja aktuale e administratës komunale në Republikën e Kosovës

Administrata lokale në Republikën e Kosovës është e organizuar në drejtorate të cilat janë themeluar konform statuteve të komunave përkatëse. Emrat e drejtorateve dallojnë nga komuna në komunë, mirëpo një pjesë bukur e madhe e komunave i ndajnë punët ndërmjet drejtorateve të administratës së përgjithshme, ekonomisë dhe financave, kadastrit dhe gjeodezisë, planifikimit hapësinor dhe ambientit, arsimit, kulturës, sportit dhe çështjeve rinore, përkujdesjes shëndetësore, politikës sociale dhe mbrojtjes civile, zhvillimit dhe rindërtimit ekonomik dhe bujqësisë dhe pylltarisë. Mirëpo, pjesa tjetër e komunave organizimin e administratës e bëjnë konform specifikave të komunave të tyre. Në secilin drejtorat, punojnë shërbyesit civil, të cilët zgjedhen në bazë të konkursit.

Administrata e komunës përbëhet prej komponentës politike, drejtorëve, të cilët emërohen nga kryetari i komunës dhe nga komponenta civile, e cila udhëhiqet nga drejtorët e emëruar, ndërsa udhëheqësi i personelit, nuk e ka të qartë pozitën e tij/saj. Drejtorët e drejtorateve më parë kanë

qenë shërbyes civil dhe e tërë administrata ka qenë e udhëhequr nga Kryeshefi ekzekutiv, po ashtu shërbyes civil.

Edhe pse komunat kanë të njëjtat kompetenca dhe përgjegjësi, ato kanë numër të ndryshëm të drejtorateve. Numri i përgjithshëm i drejtorateve është 318. Numri mesatar i drejtorateve në administratën komunale është 9. Numrin më të madh të drejtorateve e ka Mitrovica dhe Peja (14), ndërsa numrin më të vogël të drejtorateve e ka Klllokoti (5) dhe Mamusha (6). Edhe organizimi dhe emërtimi i drejtorateve është i ndryshëm nga komuna në komunë. Drejtoratet të cilat në shumicën e komunave kanë organizim dhe emërtim të njëjtë janë: Drejtorati për shëndetësi dhe mirëqenie sociale (në 31 komuna), Drejtorati për arsim dhe Drejtorati për rini kulturë dhe sport (në 25 komuna), Drejtorati për inspektion dhe Drejtorati i administratës (në 20 komuna), ndërsa drejtoratet tjera kanë emërtime të ndryshme në shumicën e komunave. Emërtimi i ndryshëm i drejtorateve shpesh herë shkakton probleme në komunikim, mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen në formë standarde të të dhënave. Sistemi administrativ aktual është i konceptuar të jetë i orientuar në ofrimin e shërbimeve.

Drejtorati për ofrim të drejtpërdrejt të shërbimeve është për 3 herë më i madh se drejtoratet me shërbime jo të drejtpërdrejta apo operative. Ky sistem i organizimit të administratës i kushton komunave 33,019,702 milion Euro apo 16.6% e buxhetit të pagave, që së bashku edhe me pagat e punëtorëve arsimor dhe të shëndetësisë arrin shumën e 198,276,639 mil. Euro apo 52.37% e buxhetit total të komunës në vit<sup>3</sup>. Ndërkaq kriteret e Bankës Botërore për menaxhimin e buxhetit nuk lejojnë kalimin e 30% të buxhetit të institucionit në kategorinë e pagave.

Struktura kualifikuese e burimeve njerëzore (BNj) në administratën komunale (2009) është jo e mjaftueshme. Shumica e të punësuarve, sipas vlerësimit në vitin 2009, janë me përgatitje shkollore të mesme - 53%, ndërsa 30% janë me fakultet, 0.60% janë me magjistraturë dhe 0.13% janë me doktoraturë<sup>4</sup>. Në bazë të këtij raporti rezulton se 81.5% e BNj kanë marrë pjesë në trajnim. Kjo tregon për një shkallë të ulët të përgatitjes shkollore dhe për një shkallë të lartë të aftësisë për të ofruar shërbimet e duhura qytetarëve. Në të gjitha vendet evropiane vërehet një trend i qartë i profesionalizimit të statusit të zyrtarëve lokal dhe forcimi i masave të nevojshme mbrojtëse për të ushtruar mandatin e tyre me sukses<sup>5</sup>. Kosova bën pjesë në grupin e 11 vendeve evropiane me sistem selektiv të karrierës, ku vetëm një pjesë e të punësuarve mund të ngritën në karrierë gjatë punës së tyre të suksesshme, përkundër shumicës së vendeve evropiane (15), që e kanë të ndërtuar sistemin e karrierës me ligj për të gjithë<sup>6</sup>. Po ashtu kontrata kolektive ende nuk zbatohet në vendin tonë ashtu si është kërkuar me ligjin e punës dhe nga sindikatat e punëtorëve. Rregullimi i marrëdhënies së punës nëpërmjet dy ligjeve, krijon dy sisteme të veprimit që në disa raste nuk e mbështesin njëri tjetrin. Si do që të jetë komunat formalisht i

<sup>3</sup> MAPL: “Analizë e Funkcionimit të Vetëqeverisjes Lokale në Kosovë”, Prishtinë, 2013.


<sup>4</sup> MAPL: “Raport për Vlerësimin e Nevojave për Ndërtim të Kapaciteteve në Komuna”, Prishtinë 2009.

<sup>5</sup> Gerard Marcou & Hellmut Eöllman: “United Cities and Local Government”, fq. 155.

<sup>6</sup> Po aty, fq. 151.



kanë të gjitha të drejtat për punësimin e të BNj dhe menaxhimin e tyre në sektorët publik, por vërehet një mundësi e tërthortë e ndikimit të ministrive të linjës nëpërmjet këshillave të përbashkëta ekzekutive të institucioneve publike, si në arsim, shëndetësi etj.



**Grafikoni 1:** Shpërndarja e të punësuarve sipas drejtorateve.

Burimet njerëzore nuk janë të shpërndara njësoj në drejtoratet e ndryshme. Numri më i madh i BNj 23% e tyre punon në drejtoratin e administratës, në drejtoratin e shërbimeve publike punojnë 16% e të punësuarve dhe 60% e të punësuarve tjerë janë të shpërndarë, mesatarisht nga 450 në 7 drejtorate tjera. Drejtorati i prokurimit është më i vogli me vetëm 61 të punësuar ose 0.9%.

Në përputhje me kompetencat që ka komuna, kompetencat e deleguara dhe ato të zgjeruara, administrata komunale ofron 29 lloje të ndryshme të shërbimeve. Komunitat nuk kanë themeluar 29 drejtorate, por shërbimet me natyrë të përafërt i kanë organizuar në drejtorate përkatëse, që më së shumti janë 14 dhe më së paku 5. Nuk ka ndonjë standard të veçantë se cilat shërbime organizohen në drejtoratet përkatëse. Kjo tregon për një sistem të hapur të organizimit të administratës, që i pengon komunitat të bashkërendojnë më lehtë shërbimet e përbashkëta. Për të vlerësuar se si PL është duke i ofruar këto shërbime për qytetarët, MAPL ka zhvilluar 95 tregues për 15 fusha të shërbimeve dhe organizon anketa me qytetarët për vlerësimin e shkallës së kënaqshmërisë së tyre.

Në administratën e komunës, krahas drejtorateve, ekzistojnë edhe zyra të ndryshme, që janë të lidhura me punën e kryetarit ose me drejtoratet e ndryshme. Numri i përgjithshëm i zyrave në nivel të vendit është 137, ndërsa mesatarja e zyrave për një komunë është 4. Numër më të madh të zyrave ka Podujeva dhe Peja (11), ndërsa 8 komuna nuk kanë zyra fare. Në të shumtën e

rasteve zyrtar janë të themeluara me U. A të ministrive të linjës ose me rregullore për organizim të brendshëm të komunës. Në administratën komunale punojnë kryesisht shërbyesit civil, të cilët krijojnë marrëdhënien e punës, të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre me Ligjin për Shërbimin Civil. Numri i të punësuarve në komuna është i caktuar me Vendimin Qeverisë Nr. 10/46. Ky numër është i përcaktuar në dy baza: numri i garantuar prej 55 të punësuarve dhe numri shtesë në bazë të numrit të banorëve të komunës. Komunitat me mbi 100.000 banorë, u takon 1 zyrtarë në 750 banorë, ndërsa komunave nën 100.000 banorë u takon 1 zyrtarë në 620 banorë.

Sa i përket komunës së Prishtinës, ajo ka 388.561 banorë (*sipas llogaritjeve para regjistrimit të fundit nga ASK-ja*). Andaj, sipas llogaritjeve të numrit të banorëve duke pjesëtuar me kriterin suplementar, që është 750 banorë me 1 punonjës administrativ ( $388561/750=518$  punonjës). Numrit të punonjësve sipas këtyre llogaritjeve i shtohet edhe kriteri bazë, që është 55 punonjës për çdo komunë ( $518+55=573$ ). Nga këto llogaritje del se numri i punonjësve për komunën e Prishtinës duhet të jetë jo më shumë se 573 (pesëqind e shtatëdhjetë) punonjës". Mirëpo, me regjistrimin e ri të popullsisë numri i të punësuarve do të ndryshojë. Administrata komunale që nga periudhat e më hershme deri në vitin 2013 ka pasur rritje të numrit të të punësuar, ku kemi këto të dhëna:

Nr.	Viti	Numri i të punësuarve	Ndryshimi
1.	2004	4826	/
2.	2011	6224	+1398
3.	2013	6384	+160

**Tabela 2:** Pasqyrimi i krahasimeve të të dhënave të punësuarve në administratën komunale në Republikën e Kosovës në mes të viteve 2004, 2011 dhe 2013.

Sipas këtyre të dhënave shohim se në vitin 2004 numri i të punësuarve në administratën komunale në Republikën e Kosovës ka qenë 4826, kurse në vitin 2011 ky numër është rritur për 1398 të punësuar në një total prej 6224. Ndërsa, në vitin 2013 ky numër ka arritur në 6384 të punësuar me një rritje prej 160 të punësuar nga viti 2011 dhe me një rritje prej 1558 të punësuar nga viti 2004.

#### 4. Kriteret aktuale të madhësisë së administratës në Republikën e Kosovës

Kriteret e madhësisë së administratës në Republikën e Kosovës janë përcaktuar sipas Ligjit të buxhetit dhe Vendimit të Qeverisë Nr. 10/46 i datës 03.12.2008, në të cilën theksohen dy kriteret bazë:

- I. *Kriteri bazë* – që të gjitha komunitat pa marrë parasysh madhësinë e tyre, bazuar në obligimet që dalin nga legjislacioni për funksionimin e tyre u nevojitet stafi në kufirin minimal prej 55. Ky numër është preciz që duhet të bëjnë dhe autoritetet komunale nuk

mund t'i ri-alokojnë në fusha apo detyra tjera dhe tabela është dhënë në aneksin A të dokumentit.

I. *Kriteri suplementar:*

- a) Komunat e Republikës së Kosovës që kanë mbi 100. 000 banorë, 1 punonjës administrativë të shërbejë për 620 qytetarë. (Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren dhe Gjilan) që 1 punonjës administrativë të shërbejë për 1. 000 qytetarë.
- b) Komunat tjera të Kosovës që kanë nën 100. 000 banorë, 1 punonjës administrativë do të shërbejë për 780 qytetarë.

Edhe pse kriteri suplementar i Vendimit Nr. 10/46 nuk korrespondon me aneksin B të këtij vendimi dhe shihen se janë lëshuar disa lëshime në këtë vendim lidhur me kriteret për ndarjen e komunave sipas numrit të banorëve dhe kriterëve për caktimin e numrit të punonjësve të administratës komunale. Megjithatë, stafi i përlogaritur në kriterin suplementar, është në dispozicion të organeve përkatëse komunale, t'i alokojnë varësisht në qëllimet e politikave lokale komunale, prioritetet e tyre, etj. Në bazë të këtyre kriterëve dhe numrit të popullsisë, si dhe numrit të punëtorëve në administratën komunale në Republikën e Kosovës, kemi këto të dhëna si vijon:

Nr.	Komuna	Popullsia	Kriteri bazë	Kriteri suplementar	Nr. i punëtorëve në Administratë
1.	Prishtinë	205,133	55	273	736
2.	Prizren	181,756	55	242	354
3.	Ferizaj	111,141	55	148	281
4.	Pejë	98,237	55	158	332
5.	Gjakovë	96,071	55	154	263
6.	Gjilan	91,413	55	147	300
7.	Podujevë	89,185	55	143	266
8.	Mitrovicë	73,160	55	118	303
9.	Vushtrri	71,042	55	114	216
10.	Suharekë	61,190	55	98	155
11.	Glogoc	59,752	55	96	137
12.	Lipjan	58,909	55	95	190
13.	Rahovec	57,451	55	92	180
14.	Malishevë	56,189	55	90	155
15.	Skenderaj	51,491	55	83	195
16.	Viti	47,636	55	76	161
17.	Istog	40,150	55	64	160
18.	Deçan	40,614	55	65	120

19.	Klinë	39,467	55	63	133
20.	Fushë-Kosovë	36,897	55	58	139
21.	Kamenicë	35,711	55	57	209
22.	Dragash	34,410	55	55	133
23.	Kaçanik	33,893	55	54	130
24.	Shtime	27,940	55	45	75
25.	Obiliq	22,011	55	35	76
26.	Leposaviq	13,682	55	22	127
27.	Mitrovica e Veriut	12,303	55	19	57
28.	Graçanicë	11,197	55	18	54
29.	Hani i Elezit	9,567	55	15	52
30.	Zveçan	7,421	55	11	57
31.	Zubin Potok	6,592	55	10	226
32.	Shtërpçë	6,966	55	11	96
33.	Novobërda	6,891	55	11	67
34.	Junik	6,212	55	10	54
35.	Mamusha	5,695	55	9	42
36.	Ranillug	3,842	55	6	58
37.	Partesh	1,766	55	2	49
38.	Klllokot	2,623	55	4	46
<b>38.</b>	<b>Totali</b>	<b>1,815,606</b>	<b>2,090</b>	<b>2,771</b>	<b>6,384</b>

**Tabela 3:** Kriteret e madhësisë së administratës komunale sipas Regjistrimit të fundit të popullsisë nga ASK-ja.

Bazuar në kriteret për madhësinë e administratës komunale në Republikën e Kosovës, përkatësisht në vendimin e lartcekur sipas aneksit B ku komunat mbi 100.000 banorë duhet të kenë 1 punonjës për 750 qytetarë dhe komunat nën 100.000 banorë duhet të kenë 1 punonjës për 620 qytetar, shohim se sipas këtyre kriterëve komunat do të duhej të kishin shumë më pak punonjës në administratën komunale sesa tani. Kjo dëshmon se kriteret mbi madhësinë e administratës komunale në Republikën e Kosovës nuk po respektohen dhe si rezultat i këtij mosrespektimi kemi mbingarkesë të administratës e cila mund të ketë efekte në mbingarkimin e buxhetit të Kosovës, pastaj efektet po ashtu mund të vërehen edhe tek mos profesionalizmi i shërbyesve civil dhe mos efikasiteti i shërbyesve civil.

Ky fakt deri më tani ka dëshmuar se me këtë mbingarkesë të administratës komunale pavarësisht faktit që niveli qendror është angazhuar që niveli lokal të krijojë një qeverisje të mirë, efikase, transparente, llogaridhënëse, etj, kemi parë një administratë jo mjaft efikase dhe efektive.

### 5. Gjendja aktuale e të punësuarve në administratat e komunave të Republikës së Kosovës

Gjendjen aktuale të të punësuarve nëpër administratat e secilës komunë të Republikës së Kosovës do ta paraqesim në mënyrë tabelore më poshtë. Të dhënat mbi të punësuarit nëpër administratat e komunave janë marrë nga Ministria e Administratës Publike, Agjencioni i Statistikave të Kosovës, si dhe burime tjera parësore dhe dytësore. Aktualisht në komunat e Republikës së Kosovës, përjashto këto ato të pjesës Veriore (Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq, si dhe Mitrovica Veriore), kemi tejkalime shumë më të mëdha sesa kriteret e caktuara, këto tejkalime janë pasqyruar si vijon:

Nr.	Komuna	Popullsia	Kriteri bazë	Kriteri suplementar	Nr. i punëtoreve në Administratë	Diferenca
1.	Prishtinë	205,133	55	273	736	408
2.	Prizren	181,756	55	242	354	57
3.	Ferizaj	111,141	55	148	281	78
4.	Pejë	98,237	55	158	332	119
5.	Gjakovë	96,071	55	154	263	54
6.	Gjilan	91,413	55	147	300	98
7.	Podujevë	89,185	55	143	266	68
8.	Mitrovicë	73,160	55	118	303	130
9.	Vushtri	71,042	55	114	216	47
10.	Suharekë	61,190	55	98	155	2
11.	Glogoc	59,752	55	96	137	-14
12.	Lipjan	58,909	55	95	190	40
13.	Rahovec	57,451	55	92	180	33
14.	Malishevë	56,189	55	90	155	10
15.	Skenderaj	51,491	55	83	195	57
16.	Viti	47,636	55	76	161	30
17.	Istog	40,150	55	64	160	41
18.	Deçan	40,614	55	65	120	0
19.	Klinë	39,467	55	63	133	20
20.	Fushë-Kosovë	36,897	55	58	139	26
21.	Kamenicë	35,711	55	57	209	96
22.	Dragash	34,410	55	55	133	23
23.	Kaçanik	33,893	55	54	130	21
24.	Shtime	27,940	55	45	75	-25
25.	Obiliq	22,011	55	35	76	-14
26.	Leposaviq	13,682	55	22	127	50

27.	Mitrovica e Veriut	12,303	55	19	57	-17
28.	Graçanicë	11,197	55	18	54	-19
29.	Hani i Elezit	9,567	55	15	52	-18
30.	Zveçan	7,421	55	11	57	-9
31.	Zubin Potok	6,592	55	10	226	161
32.	Shtërpçë	6,966	55	11	96	30
33.	Novobërda	6,891	55	11	67	1
34.	Junik	6,212	55	10	54	-11
35.	Mamusha	5,695	55	9	42	-22
36.	Ranillug	3,842	55	6	58	-3
37.	Partesh	1,766	55	2	49	-8
38.	Klllokot	2,623	55	4	46	-13

**Tabela 4:** Madhësia e administratës komunale dhe diferenca e punonjësve.


Nga të dhënat e tabelës Nr. 4, shohim se vetëm komuna e Deçanit e ka numrin e të punësuarve në pajtim me kriteret e caktuara për madhësinë e administratës komunale. Ndërsa, komunat të cilat e kanë tejkaluar dhe të cilët kanë mangësi në numrin e të punësuarve nëpër administrata komunale janë paraqitur në tabelën e më poshtme.

## 6. Komunitat të cilat kanë tejkaluar numrin e punonjësve

Nr.	Komuna	Popullsia	Kriteri bazë dhe kriteri suplementar	Nr. i punëtoreve në Administratë	Diferenca
1.	Prishtinë	205,133	328	736	408
2.	Prizren	181,756	297	354	57
3.	Ferizaj	111,141	203	281	78
4.	Pejë	98,237	213	332	119
5.	Gjakovë	96,071	209	263	54
6.	Gjilan	91,413	202	300	98
7.	Podujevë	89,185	198	266	68
8.	Mitrovicë	73,160	173	303	130
9.	Vushtrri	71,042	169	216	47
10.	Suharekë	61,190	153	155	2
11.	Lipjan	58,909	150	190	40
12.	Rahovec	57,451	147	180	33
13.	Malishevë	56,189	145	155	10
14.	Skenderaj	51,491	138	195	57

15.	Viti	47,636	131	161	30
16.	Istog	40,150	119	160	41
17.	Klinë	39,467	118	133	20
18.	Fushë-Kosovë	36,897	113	139	26
19.	Kamenicë	35,711	112	209	96
20.	Dragash	34,410	110	133	23
21.	Kaçanik	33,893	109	130	21
22.	Leposaviq	13,682	77	127	50
23.	Zubin Potok	6,592	65	226	161
24.	Shtërpcë	6,966	66	96	30
25.	Novobërda	6,891	66	67	1
25.	<b>Totali</b>	<b>1,604,663</b>	<b>3,811</b>	<b>5,507</b>	<b>1,700</b>

**Tabela 5:** Pasqyrimi i të dhënave në komunat e Republikës së Kosovës të cilat e kanë tejkaluar numrin e punonjësve.



**Diagrami 1:** Pasqyrimi i të dhënave në komunat e Republikës së Kosovës të cilat e kanë tejkaluar numrin e punonjësve.


Bazuar nga këto të dhëna shohim se nga gjithsej 38 komuna të Republikës së Kosovës (edhe pse komunat e pjesës Veriore ende nuk janë funksionale) 25 (ose 65%) prej tyre janë komuna që e kanë tejkaluar numrin e të punësuarve në administratën komunale me tejkalim të numrit të punësuarve prej 1,700 punonjës. Me numrin më të lartë të të punësuarve prin komuna e Prishtinës, duke pasuar ajo e Prizrenit si dhe në fund të këtij diagrami shihet se është komuna e Novobërdës.

## 7. Komunitat të cilat kanë mungesë të punonjësve

Ndërsa, sa i përket komunave të cilat kanë mungesë të punonjësve, bazuar edhe në regjistrimin e fundit të popullsisë nga ASK-ja kemi këto të dhëna si vijon:

Nr.	Komuna	Popullsia	Kriteri bazë dhe kriteri suplementar	Nr. i punëtorëve në Administratë	Diferenca
1.	Glogoc	59,752	151	137	-14
2.	Shtime	27,940	100	75	-25
3.	Obiliq	22,011	90	76	-14
4.	Mitrovica e Veriut	12,303	74	57	-17
5.	Graçanicë	11,197	73	54	-19
6.	Hani i Elezit	9,567	70	52	-18
7.	Zveçan	7,421	66	57	-9
8.	Junik	6,212	65	54	-11
9.	Mamusha	5,695	64	42	-22
10.	Ranillug	3,842	61	58	-3
11.	Partesh	1,766	57	49	-8
12.	Kllkot	2,623	59	46	-13
<b>12.</b>	<b>Totali</b>	<b>170,329</b>	<b>930</b>	<b>757</b>	<b>-173</b>

**Tabela 6:** Pasqyrimi i të dhënave në komunat e Republikës së Kosovës të cilat kanë mungesë të numrit të punonjësve



**Diagrami 2:** Pasqyrimi i të dhënave në komunat e Republikës së Kosovës të cilat kanë mungesë të numrit të punonjësve



## 8. Përvojat e shteteve të rajonit dhe Evropës lidhur me Administratën komunale

Administrata komunale në Evropën juglindore zakonisht shihet si mekanizëm institucional në të cilin është investuar një kohë të gjatë. Sot, kjo administratë është funksionale dhe është e përherëshme. Administratën në këto vende të BE-së kryesisht e përbëjnë njerëzit profesionist, përkatësisht shërbyesit civil në të cilët është investuar shumë nga ana e shtetit. Ndërsa, madhësia e administratës në këto vende dallon shumë nga vendi në vend, p.sh:

Shtetet	Të punësuarit në sektorin publik në 1.000 banorë
Norvegji	182
Rusi	153
Letoni	141
Suedi	138
Slloveni	117
Sllovaki	96
Poloni	95
Greqi	91
Bulgari/Hungari	82
Rumania	80

**Tabela 7:** Të punësuarit në administratën publike në disa shtete të Evropës<sup>7</sup>.

Pra, siç shihet nga kjo tabelë, secili shtet dallon dukshëm nga shteti tjetër për nga numri i shërbyesve civilë për banorë. P.sh. “në Hungari struktura e shërbyesve civilë është si vijon: administrata qendrore – 26. 600 persona, administrata rajonale 26. 600 persona dhe lokale 45. 800 persona. Në Bullgari numri i njerëzve të punësuar në administratën publike është rreth 60. 000 njerëz që përfaqësojnë rreth 12% të totalit të të punësuarve të sektorit publik.

Në Slloveni, aktualisht administrata publike ka 32. 000 punonjës civilë nga të cilët rreth 4. 000 janë të punësuar në njësitë e qeverisjes lokale që përfaqësojnë rreth 4% të popullsisë aktive<sup>8</sup>. Ndërsa, sipas një dokumenti tjetër shihet se nga viti 1995 deri në vitin 2005 ka pasur fare pak ndryshime sa i përket numrit dhe madhësisë së administratës publike (administrata e përgjithshme lokale dhe qendrore) në disa shtete të zhvilluara, të cilat të dhëna i kemi paraqitur në tabelën e mëposhtme, si vijon:

<sup>7</sup> Onofrei, Mihaela: “*The Dimension of Public Administration in Central and Eastern European Countries in the Current Financial Crisis*”, Romania, 2009, fq. 112.

<sup>8</sup> Po aty, fq. 125 – 130.

Shteti	Të punësuarit në administratën publike			Të punësuarit në sektorin e edukimit			Të punësuarit në sektorin e shëndetësisë		
	1995	2005	Ndryshimi	1995	2005	Ndryshimi	1995	2005	Ndryshimi
Austria	3.9	4.1	0.2	4.0	4.0	0.0	5.3	6.3	1.0
Rep. Çeke	3.3	4.1	0.7	4.4	4.1	-0.3	4.0	4.5	0.5
Gjermania	4.6	3.5	-1.1	3.3	3.8	0.5	5.9	7.5	1.6
Belgjika	3.4	5.5	2.1	/	5.7	/	/	7.5	/
Greqia	0.9	2.6	1.7	3.2	4.4	1.1	2.4	3.1	0.7
Italia	3.8	3.3	-0.4	3.6	4.0	0.3	3.2	4.0	0.8
Luksemburgu	3.9	5.2	1.3	3.6	4.8	1.1	4.9	7.5	2.6
Holanda	4.4	4.5	0.1	4.2	4.7	0.5	8.9	11.0	2.2
Portugalia	4.1	4.3	0.2	4.7	4.4	-0.3	3.0	4.6	1.6
Spanja	2.1	3.6	1.5	2.7	3.7	1.0	2.5	3.9	1.4
Danimarka	4.0	4.2	0.2	5.3	6.1	0.8	12.4	13.3	0.9
Finlanda	3.2	2.8	-0.4	4.1	4.8	0.7	8.7	10.5	1.7
Norvegjia	3.8	3.7	-0.1	5.9	6.4	0.4	13.4	15.5	2.0
Suedia	2.4	4.9	2.5	5.2	8.2	3.0	7.2	7.9	0.8
Kanada	3.8	3.6	-0.3	4.8	5.1	0.3	7.2	7.9	0.8
Irlanda	2.3	3.4	1.1	3.8	4.4	0.5	4.5	6.7	2.2
Mbretëria e Bashkuar	3.6	4.7	1.1	5.3	6.7	1.4	7.6	9.1	1.5

**Tabela 8:** Pasqyrimi i përqindjeve dhe ndryshimeve të të punësuarve në disa shtete të zhvilluara<sup>9</sup>.

Siç shihet në këtë tabelë nuk janë të ndarë të punësuarit në administratën lokale dhe qendrore, por të dhënat pasqyrojnë të punësuarit dhe probabilitetin e të punësuarve në administratën publike në përgjithësi dhe ndryshimet brenda një dekade.

<sup>9</sup> Tepe, Makcus: "Public Administration Employment in 17 OECD nations from 1995 to 2005", RWWW, Edinburg, 2009, fq. 13.

## 9. Dallimet në mes të administratës komunale në Kosovë dhe shteteve tjera

Bazuar në të dhënat e mësipërme shohim se shtetet e zhvilluara sidomos ato të BE-së kanë disa kriteret mbi madhësinë e administratës publike, të cilat i kanë caktuar konform direktivave të BE-së dhe legjislacionit të tyre. Këto kriteret të madhësisë së administratës kryesisht lidhen me kriterin e numrit të popullsisë i cili është kriter bazë dhe i cili cakton 1 punonjës në 1.000 banorë (për shkak të mbipopullimit në këto shtete), pastaj kriteri gjeografik varësisht nga zona në të cilin banojnë më shumë qytetar, që kryesisht shquhet si kriter territorial ose sipërfaqja km<sup>2</sup> (shih: shteti Slloven). Edhe pse realisht nuk janë të specifikuar në mënyrë decidive këto kriteret. Megjithatë, një pjesë bukur e madhe e këtyre shteteve të Evropës si kriter thelbësor e marrin përqindjen e buxhetit për numrin e të punësuarve në administratën publike.

Mirëpo, ajo që i dallon këto shtete nga Kosova është numri i vogël i punonjësve në administratën lokale përveç shtetit të Rumanisë i cili si shtet ka pasur probleme të shumta me BE-n lidhur me natyrën e këtyre çështjeve. Shtetet tjera këtë numër aktualisht e kanë ulur si rezultat i reformave dhe implikimeve buxhetore të cilat i kanë përcjellë këto shtete sidomos më krizën globale. Ndërsa, në Kosovë siç e pamë më lartë, shihet se numri i punonjësve është tejkaluar, gjë që mund të ketë jo vetëm implikime buxhetore, por edhe probleme të natyrave tjera.

## 10. Profili i administratës publike në Republikën e Kosovës

Pas specifikimit të këtyre kriterëve, administrata publike në Kosovë (administrata lokale) do të duhej të ketë një profil të saj ashtu siç është e organizuar në vendet e BE-së. Kështu që, sa i përket profilit të administratës publike në Kosovë ajo duhet të ketë profilin Weberian të administratës, gjë që nënkupton se administrata në Kosovë së pari do të duhej të jetë e organizuar dhe e reformuar në bazë të kriterëve mbi madhësinë e administratës, pastaj të bëhet tërësisht digjitalizimi i saj, në mënyrë që qytetarët të kenë më lehtë në aplikimin e procedurave për shërbime, të jetë e paanshme, etike, profesionale, efikase dhe mbi të gjitha transparente në raport me qytetarët.

Kjo bëhet përmes profesionalizmit të stafit të administratës lokale, ngritjes së kapaciteteve të tyre përmes trajnimeve sistemore, investimeve, në mënyrë që qytetarët të kenë shërbime më kualitative, shërbime efikase dhe administrata komunale të jetë konform parimeve të BE-së.

## 11. Përfundim

Në bazë të analizave për gjendjen aktuale që përmblohdhëm deri më tani, mund të themi se kriteret e madhësisë së administratës komunale në Kosovë janë të caktuara sipas Vendimit të Qeverisë Nr. 10/46 i datës 03.12.2008, në të cilën theksohen dy kriteret bazë: kriteri bazë i cili nënkupton se të gjitha komunat e Republikës së Kosovës pa marrë parasysh madhësinë gjeografike apo numrin e banorëve duhet të kenë numrin minimal të punonjësve në 55. Kurse, kriteri i dytë që njihet si kriter suplementar është i shpjeguar në aneksin B të këtij vendimi sipas të cilit komunat me mbi 100.000 banorë duhet të kenë një punonjës në 750 banorë dhe komunat nën 100.000 banorë duhet të kenë 620 banorë shohim se këto kriteret nuk janë respektuar dhe se komunat e Republikës së Kosovës kanë mbingarkesë sa i përket administratës.

Administrata komunale e disa shteteve rajonale dhe të BE-së ka numër më të vogël të punonjësve, pavarësisht faktit që të dhënat nga këto shtete specifikojnë numrin e përgjithshëm të administratës qendrore dhe lokale. Por, ajo që vërehet tek këto shtete është ndryshimi shumë i vogël në mes të periudhave të ndryshme (dekadave) sa i përket përqindjes së punonjësve në administratën publike.

Këto ndryshime vërehen me një përqindjeje të vogël të ngritjes dhe uljes së punonjësve në këtë fushë, por që specializimi, profesionalizimi dhe modernizimi i administratës vërehen shumë qartë. Shtetet në fjalë, kanë bërë investime kualitative dhe jo kuantitative sa i përket punonjësve në administratë. Reformat e theksuara (për shtetet e BE-së) në kuadër të integritimeve evropiane kanë theksuar se administrata publike në këto shtete ka pasur progrese, përveç shtetit të Rumanisë e cila ka pasur probleme të theksuara me mbi ngarkesën e punonjësve në këtë sferë. Megjithatë, shikuar në përgjithësi nuk ka ndonjë specifikim të kriterëve mbi madhësinë e administratës në këto shtete, por kryesisht ky fakt varet edhe nga të hyrat vetanake, sipërfaqja e komunave, si dhe nga përqindja e buxhetit.

Pra, thënë më gjerësisht, bazuar nga këto elaborime *Administrata* aktuale në Republikën e Kosovës e ka tejkaluar numrin e punonjësve sipas kriterëve të përgjithshme të caktuara në bazë të vendimit të Qeverisë (kriterit bazë dhe suplementar), të cilat mund të kenë pasojat në shpërndarjen e drejtë të shërbimeve, pastaj në ngarkesën e buxhetit, stabilitetin e administratës dhe profesionalizmin e shërbësve civil. Ky tejkalim i punonjësve në administratën komunale ka ardhur si rezultat ndryshimeve politike dhe jo si rezultat i kriterëve të madhësisë së administratës dhe nevojave të qytetarëve.

Duke u bazuar në të gjeturat e lartcekura, shihet se kriteret aktuale për madhësinë e administratës komunale nuk janë respektuar në tërësi dhe mendojmë që duhet shtuar edhe disa kriteret shtesë në mënyrë që administrata të jetë më efikase dhe më efektive në ofrimin e shërbimeve të qytetarëve. Në përputhje me këtë po i listojmë disa rekomandime në vazhdim.

## 12. Rekomandimet

Në bazë të kësaj analize të shkurtër mbi madhësinë e administratës dhe kriterëve të cilat duhet t'i ketë Republika e Kosovës, si dhe krahasimeve që kemi bërë me disa shtete të rajonit dhe të BE-së, konsiderojmë se administrata lokale duhet t'i analizon rekomandimet konkrete, në mënyrë që të ketë një stabilitet në funksionimin e administratës në përgjithësi, ngritje të kapaciteteve njerëzore, sigurim të shpërndarjes së drejtë të shërbimeve dhe jo ngarkesë të buxhetit të Kosovës, rekomandojmë:

- *Kriteri bazë* prej 55 punonjësve administrativ i bazuar në Vendimin e Qeverisë Nr. 14/46 të jetë ashtu siç është i caktuar tani.
- *Kriteri suplementar* (shtesë) të bëhet varësisht nga numri i popullsisë dhe kriterëve tjerë që caktohen për administratën komunale.
- Në kuadër të kriterit shtesë duhet të vendosen edhe disa nënkritere tjerë të cilat do të ndihmonin që madhësia e administratës lokale e përcaktuar me një formulë përkatëse të jetë në përputhje me gjendjen specifike të secilës komunë.
- Nënkriteret të cilat do të duhej të merren në konsiderim janë: madhësia territoriale e komunës, numri i vendbanimeve, numri i shërbimeve të ofruara dhe kufiri buxhetor i lejuar për paga. Një nënkriter i veçantë duhet të vendoset për komunën e Prishtinës.
- Përcaktimi i nënkritereve shtesë duhet të harmonizohen edhe me Ligjin për Financat Lokale.
- Të vendosen nënkriteret me një formulë specifike në një aneks të veçantë.

### 13. Burimet/literatura

1. Kuvendi i Kosovës: *“Ligji për Vetëqeverisjen Lokale”*, neni 62, pika 62.1 dhe 62.2.
2. Prof. dr. Gjermo, Zenaid: *“Teoria e Administratës Publike”*, AAB, Prishtinë, 2008.
3. Marcou & Hellmut Wollman: *“United Cities and Local Government”*.
4. MAPL: *“Analizë e Funksionimit të Vetëqeverisjes Lokale në Kosovë”*, Prishtinë, 2013
5. MAPL: *“Raporti i Përgjithshëm i Buxheteve Komunale 2000 – 2013”*, Prishtinë 2013.
6. MAPL: *“Raport për Vlerësimin e Nevojave për Ndërtim të Kapaciteteve në Komuna”*, Prishtinë 2009.
7. Onofrei, Mihaela: *“The Dimension of Public Administration in Central and Estern European Countries in the Current Financial Crisis”*, Romania, 2009.
8. Tepe, Makcus: *“Public Administration Employment in 17 OECD nations from 1995 to 2005”*, RWWW, Edinburg, 2009.